



DUELI I HESHTUR MES ARSIMIT PRIVAT DHE PUBLIK

RAPORT MONITORIMI

Dhjetor 2023



AUTOR
MARSELA DELIJA

QENDRESA
QYTETARE



NED

NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

www.qeverisja.qq.com.al

Tabela e përmbajtjes:

1. Hyrje
2. Dallimet midis arsimit privat dhe publik
3. Tendencat e Regjistrimeve në Shkolla Publike/Jopublike ndër vite
4. Cilësia e Mesimdhënies
5. Përfaqësimi i nxënësve në olimpiada
6. Buxheti për arsimin
7. Dis/avantazhi i shkollave private
8. Perfundime
9. Rekomandime

Hyrje

Arsimi është themelor për përmirësimin e jetës dhe standardeve të jetesës së njerëzve, rritjen e konkurrencës në një ekonomi dhe arritjen e përfshirjes dhe lëvizjes sociale.

"Teoria kapitaliste njerëzore", thekson rolin e kapitalit njerëzor në zhvillimin ekonomik. Ky koncept thekson rëndësinë e arsimit, pasi ai përmirëson njohuritë dhe aftësitë e individëve, duke kontribuar në mënyrë të konsiderueshme në përparimin ekonomik, konkurrencën dhe lëvizjen shoqërore. Për më tepër, teoria nënvizon rëndësinë e përmirësimit të vazhdueshëm, duke theksuar rafinimin e vazhdueshëm të aftësive dhe njohurive për suksesin e qëndrueshëm individual dhe kolektiv.

Vendi ynë iu nënshtrua testit të PISA¹ nga ku dolën rezultatet që ka humbur plot 47 vende në lexim, 41 vende në shkencë dhe 69 vende në matematik në krahasim me rezultatet e viti 2018, duke shënuar përkeqësimet më të mëdha në krahasim me të gjitha vendet e marra në konsideratë në nivel global.²

Përkeqësimi i rezultateve të nxënësve në Shqipëri, vërejtur në PISA 2022, duket të jetë i lidhur me faktorë të ndryshëm. Në fund të vitit 2019, një tërmet i fuqishëm goditi Shqipërinë, duke shkaktuar dëme në infrastrukturë, duke përfshirë shkolla dhe shtëpi, në 12 qytete kryesore. Ndjekjet shkaktuar nga tërmeti dhe nga Covid-19 në jetën psiko-sociale të nxënësve mund të kenë pasuar një ndikim negativ në pjesëmarrjen e nxënësve në PISA 2022. Në një periudhë të caktuar, mësimi u zhvillua në distancë për disa muaj me rradhë, dhe Shqipëria nuk ishte e përgatitur për kalimin e mësimdhënies në mënyrë tërësisht online.

Megjithatë le të marrim në vëzhgim dy sfera të ndryshme në sistemin e arsimit para-universitar, shkollat publike dhe ato private. Lëvizjes së 10 viteve të fundit që ka pasur drejt arsimit privat nga ai publik dhe cilët kanë qënë faktorët që kanë avantazhuar arsimin privat në vendin tonë.

¹ PISA - Programi për Vlerësimin Ndërkombëtar të Nxënësve është një studim ndërkombëtar i zhvilluar nga Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD)

² OECD (2023), PISA 2022 Results (Volume I): The State of Learning and Equity in Education, PISA, OECD Publishing, Paris, <https://doi.org/10.1787/53f23881-en>

Dallimet midis arsimit privat dhe publik

Shkollat publike janë të menaxhuara nga një autoritet ose agjensi arsimore publike.

"Shkollë private" është shkolla jopublike, e cila nuk themelohet, financohet dhe administrohet nga qeveria qendrore ose vendore.³

Kur bëhet fjalë për arsimin, një nga vendimet më të rëndësishme për fëmijën tuaj është të zhgjidhni midis shkollave. Mundësitë janë dy - shkolla publike dhe ajo private. Nëse kuptoni dallimet kryesore, mund të bëni një zgjedhje të mirë në vendimarrjen tuaj.

Ekspertët dhe hulumtuesit në fushën e arsimit thonë se prindërit duhet të shikojnë një sërë faktorësh kur zgjedhin një shkollë për fëmijën e tyre, duke përfshirë:

- Rezultatet arsimore, si normat e diplomimit dhe regjistrimi në universitet
- Madhësia e klasave
- Trajnim i mësuesve
- Diversiteti
- Ndërhyrjet dhe programet për fëmijët me vështirësi në nxënie

Ndryshimet në karakteristika të studentëve në shkolla private dhe publike: në shkollat private në Shqipëri nxënësit i përkasin një niveli me të lart socio-ekonomik si dhe shkollat private ofrojnë resurse më të mira.

4

Në 16 vende të OECD dhe 10 vende dhe ekonomi partnere, studenti i zakonshëm i shkollës private zakonisht performon më mirë se studenti i zakonshëm i shkollës publike. Ky "avantazh" i shkollave private shfaqet në rezultatet e leximit të PISA (Programi për Vlerësimin Ndërkombëtar të Nxënësve), ku pikët e leximit janë 30 më të larta për studentët e shkollave private krahasuar me studentët e shkollave publike në zonën e OECD.⁵


³ (Ligji Nr. 69/2012 PËR SISTEMIN ARSIMOR PARAUNIVERSITAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË)

⁴ <https://ëëë.oecd.org/pisa/pisaproducts/pisainfocus/48482894.pdf>


⁵ <https://ëëë.oecd.org/pisa/pisaproducts/pisainfocus/48482894.pdf> Page 1

Numri i nxënësve në arsim privat

Shkolla Publike vs.



Shkolla jopublike vs.



	Shkolla publike	Shkolla jopublike	Gjithsej
2012-2013	584,078	43,049	627,127
2013-2014	566,557	43,902	610,459
2014-2015	545,436	40,509	585,945
2015-2016	515,981	40,521	556,502
2016-2017	492,920	43,492	536,412
2017-2018	457,831	42,323	500,154

2018-2019	437,314	43,517	480,831
2019-2020	415,280	47,326	462,606
2020-2021	400,581	46,202	446,783
2021-2022	386,353	49,357	435,710

Në vitin 2013, numri i nxënësve në arsimin publik dhe privat ishte një pjesë e peizazhit arsimor. Nga atëherë deri më tani, ka ndodhur një ndryshim i konsiderueshëm. Për shembull, mund të shohim zhvillime në numrin e nxënësve të regjistruar në arsimin privat për periudhën 2012-2022 ka ardhur në rritje. Këto ndryshime reflektojnë ndryshimin e preferencave të prindërve dhe politikave arsimore të vendit. Këto ndryshime ofrojnë një perspektivë më të thellë mbi zhvillimet dhe sfidat që kanë ndikuar në sistemin arsimor gjatë këtyre viteve.

Cilësia e mësimdhënies

Arsimi i mirëfilltë përqendrohet në cilësinë e mesimdhënies dhe ka një impakt të thellë në zhvillimin e individit dhe shoqërisë. Ky koncept kërkon jo vetëm përcjelljen e informacionit, por gjithashtu të nxisë mendimin kritik, krijimtarinë dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës. Një analizë e cilësisë së arsimit përfshin vlerësimin e metodeve mësimore, materialeve didaktike dhe ambientit shkollor. Përveç aspektit akademik, vlerësohet gjithashtu aftësia e sistemit arsimor për të zhvilluar aftësi praktike dhe sjellje sociale të nxënësit. Në këtë analizë, do të marrim parasysh performacën e nxënësve të shkollave publike përball atyre private në:

-Diferenca ndërmjet notës mesatare të shkollës, në provimet e lëndëve të detyruara dhe gjithashtu me notën mesatare të këtyre lëndëve, në klasën e 12-të.

-Numri i fituesve të shkollës në konkurrimin, (olimpiadat, konkurse, aktivitete) që shpall ministria përgjegjëse e arsimit. Këto faktorë merren parasysh edhe nga zhvillimi i përvitshëm i kartës së performacës i zhvilluar nga çdo ZVA në vend.


Performanca e shkollave publike dhe jopublike sipas "KARTA E PERFORMANCES ZVAT 2022". Sipas pikëve të mbledhura në kartën e performacës për vitin 2022 për gjimnazet e Tiranës, shkollat jo-publike rezultojnë më lart në renditje. ⁶

⁶ <https://app.box.com/s/ara24r6om96mk3o0azastm9namb758g8>


Diferenca ndërmjet notës mesatare të shkollës, dhe notë së maturë shtetërore

Krahasuar Publik dhe jopublik

Shkollë Publike and Shkollë Jopublike



Nota mestare e Matures Shteterore




Në të dyja tabelat shikojmë performacë më të lartë të nxënësve në shkollat jopublike në performacën e tyre akademikë. Krahasimi i vlerave të notës mesatare vjetore me notën mesatare të

Maturës Shtetërore, rezulton se ndryshueshmëria është me 1.65 për shkollat publike dhe 1.39 për shkollat jopublike.⁷

Përfaqësimi i nxënësve në olimpiada⁸

Fituesit e Olimpiadave Kombëtare për vitin 2023, të zhvilluar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit.

Fituesit në Olimpiada për vitin 2023



Konkretisht nga 54 fitues, 28 prej tyre ishin në shkolla publike dhe 26 prej tyre në shkolla jopublike.

Është e rëndësishme që këtë të dhënë ta shikojmë në proporcion me numrin e nxënësve në secilin sistem, pra 28 fitues për 286,353 nxënës dhe 26 fitues për 49,357 nxënës.

⁷ http://qsha.gov.al/infos/matura_2021/raport_public_msh2021.pdf faqe 18, Tabela Gj-L – 1

⁸ <https://ëëë.portalishkollor.al/neës/emrat-e-55-nxenesve-fitues-te-olimpiadave-kombetare-2023>

Buxheti per arsimin

Buxheti për arsimin për 5 vitet e fundit⁹

Viti	Buxheti	% PBB (prodhim i brendshem bruto)
2023	47 miliard e 174 milion lekë (47,174,000)	2.2%
2022	45 miliard e 458 milion lekë (45,458,000)	2.51%
2021	42 miliard e 214 milion lekë (42,214,000)	2.51%
2020	41 miliard e 979 milion lekë (41,979,000)	2.33%
2019	39 miliard e 135 milion lekë (39,135,000)	2.33%

Gjatë 5 viteve të fundit shikojmë rritje të buxhetit për arsimin, megjithatë me gjithë rritjen, Shqipëria është vendi me nivelin më të ulët të shpenzimeve për arsimin në raport me Prodhimin e Brendshëm Bruto në rajon. Kosova kryeson me 4.6 për qind të Prodhimit të Brendshëm Bruto, ndjekur nga Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbia.¹⁰ Qeveria Shqiptare vazhdon të mos e shikojë arsimin me prioritet.

Edhe pse ka pasur rritje të buxhetit për arsimin dhe nga ana tjetër ulje të numrit të nxënësve në shkolla, nuk ka pasur rritje të rezultateteve të nxënësve. Përkundrazi, sipas testit PISA, arsimit në Shqipëri ka pasur përkeqësim.

Reformat e ndërmarra për të përmirësuar cilësinë e arsimit në vend, nuk kanë qenë efikase.

Avantazhi i shkollave private, për shkak të rënies së cilësisë në shkollat publike

Përtej të dhënave nga rezultatet e mësipërme, ku shkollat jopublike performojnë më mirë, një nga arsytet pse prindërit zgjedhin shkollat private për fëmijët e tyre është edhe infrastruktura, oraret e shkollës,

⁹ <https://arsimi.gov.al/buxheti-dhe-financat/>

¹⁰ <https://a2neës.com/shqiperia/ekonomi/buxheti-per-arsimin-ne-2024-rritet-me-45-mld-leke-por-mbetet-s-i1107844>

transporti, ushqimi, etj. Është e rëndësishme të theksohet se oraret e shkollave publike në vend nuk pershtaten me oraret zyrtare të punës, duke sjellë sfida për prindërit dhe fëmijët. Për më tepër, shkollat publike nuk ofrojnë shërbime shtesë si transporti, ushqimi në shkolla apo aktivitete "afterschool", të cilat jo vetëm që aftësojnë nxënësit në disiplina të tjera përveç atyre akademike, por gjithashtu janë një lehtësi për shumë prindër që kanë detyrime pune. Ky aspekt mund të jetë një faktor kryesor në vendimin e prindërve për t'i dërguar fëmijët e tyre në shkolla private, ku vitet e fundit e shikojmë këtë fenomen në rritje.

Në vitin 2028, MAS nisi pilotimin e projektit "Bëjmë detyrat e shtëpisë". Projekti mundëson që pasdite nxënësi të kryejë detyrat e shtëpisë dhe të bëjë mësimet brenda mjediseve të shkollës. Kjo për t'i ardhur në ndihmë nxënësve, të cilët nuk mund t'i përfundojnë dot detyrat në shtëpi, duke mos ecur dot në një hap me bashkëmoshatarët e tyre. Gjithashtu fëmijët mund të qëndronin të sigurtë në shkollë gjatë kohës që ata ishin në punë.¹¹

Ky projekt nuk ka pasur sukses, pasi nuk është vazhduar në asnjë nga shkollat e Shqipërisë.

Politikat e paqëndrueshme në sistemin arsimor, dhe mos ofrimi i kushteve të nevojshme bazë në shkollat publike i detyron prindërit që të zgjedhin arsimin jopublik.

Përfundime

-Niveli i arsimit në Shqipëri mbetet ndër më të ulëtit në Evropë. Kjo pasqyron sfidat sistemike të financimeve të ulëta, qeverisjes të paqëndrueshme dhe kapaciteteve të kufizuar.

-Në vitet e fundit, ka pasur një rritje në numrin e studentëve të regjistruar në arsimin privat, duke reflektuar preferencat e prindërve dhe politikat arsimore në vend.

-Shkollat private shkëlqejnë në performancën akademike, siç tregohet në pikët më të larta në testet standarde si PISA. Të dhënat gjithashtu tregojnë një trend të vazhdueshëm të performancës më të mirë në shkollat jo-publike gjatë viteve. Performanca e nxënësve në shkollat publike dhe private krahasohet bazuar në faktorë si nota mesatare,

¹¹ <https://www.kryeministria.al/neesroom/bejme-detyrat-e-shtepise-nisma/>

rezultatet në provime e maturës shtetërore, dhe suksemi në konkurse kombëtare. Shkollat jo-publike, kanë tendencë të renditen më lart në vlerësimet e performancës.

-Shqipëria është vendi me nivelin më të ulët të shpenzimeve për arsimin në raport me Prodhimin e Brendshëm Bruto në rajon.

-Shkollat publike nuk ofrojnë transport, ushqim, aktivitete "after school". Përtej konsideratave akademike, sfidat në infrastrukturën e shkollave publike, përfshirë oraret jo të përshtatshme dhe mungesën e shërbimeve shtesë, kontribuojnë në avantazhin e arsimit privat.

Rekomandime:

- Të zhvillohen reforma për të përmirësuar efikasitetin e sistemit arsimor duke u konsultuar me aktorët kyçë, përfshirë prindërit dhe mësuesit.
- Investime në trajnimin dhe zhvillimin e mësuesve për të rritur cilësinë e mësimdhënies. Programet inovative dhe metodologjitë moderne duhet të përdoren për të përmirësuar efikasitetin e mësimdhënies.
- Qeveria duhet të konsiderojë arsimin si një prioritet dhe të angazhohet në rritjen e buxhetit për arsim për të siguruar një infrastrukturë shkollore të përmirësuar, trajnim cilësor për mësuesit, zhvillim të programeve inovative dhe sigurimin e resurseve të nevojshme, duke krijuar kushte të përmirësuar.
- Investime në infrastrukturë dhe ofrimin e shërbimeve shtesë në shkollat publike, duke përfshirë transportin, ushqimin dhe aktivitetet "after school". Kjo do të kontribuonte në përmirësimin e eksperiencës në shkolla.

#QËNDRESË / MIRËQEVERISJE



QENDRESA
QYTETARE



NED

NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

www.qeverisja.qq.com.al